

# **Termet e Referencës për Ekspertin e Jashtëm për Zhvillimin e Programit Gjithëpërfshirës për Qendrën Komunitare të Aleanca LGBTI+**

## **1. Konteksti dhe Qëllimi**

Eksperti/ja i/e jashtëm do të zhvillojë një program gjithëpërfshirës për qendrën komunitare të Aleancës. Ai/ajo dotë hartojë kornizën e programit, do të përshkruajë dhe do të paraqesë në mënyrë të qartë të gjitha shërbimet dhe mbështetjen e disponueshme për qytetarët LGBTI+. Programi do të sigurojë që përfituesit të jenë të mirëinformuar dhe të kenë mundësinë jo vetëm të përdorin në mënyrë efektive burimet dhe mbështetjen e ofruar nga organizata por edhe të kërkojnë llogari.

## **2. Objektivat kryesore**

Eksperti/ja i/e angazhuar do të ketë për detyrë:

- Zhvillimin i një kornize dhe të përshkruajë në mënyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e qendrës komunitare.
- Hartimin i materialeve informuese me gjuhë miqësore për përfituesit LGBTI+ që pasqyrojnë qartë mbështetjen, aktivitetet dhe shërbimet e ofruara.
- Rishikimin dhe përmirësimin i mekanizmave aktualë të komunikimit, aksesit dhe llogaridhënies për përfituesit.
- Sigurimin i integritetit të politikave gjithëpërfshirëse për të gjitha grupet brenda komunitetit LGBTI+, duke përfshirë personat transgjnorë, lezbike, gej, biseksualë dhe interseks.

## **3. Detyrat Kryesore**

Eksperti/ja i/e angazhuar do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Kryerja e një analize fillestare të shërbimeve ekzistuese të qendrës komunitare.
- Konsultimi me stafin e Aleancës dhe përfituesit për të kuptuar nevojat dhe sfidat aktuale.
- Zhvillimi i një plani konkret zbatimi për organizimin dhe promovimin e shërbimeve të qendrës.
- Hartimi i një programi të detajuar që përfshin shërbime sociale, ligjore, psikologjike dhe mbështetje për edukimin dhe vetë-zhvillimin.
- Ofrimi i trajnimeve për stafin dhe vullnetarët për implementimin efektiv të programit.
- Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit fillestar të programit dhe propozimi i përmirësimeve të mundshme.

## **4. Produktet Kryesore**

Eksperti/ja do të dorëzojë këto dokumente:

- Një program gjithëpërfshirës, i dokumentuar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga përfituesit.
- Materiale të përditësuara dhe të mirëstrukturuara për informimin e komunitetit LGBTI+ mbi shërbimet e qendrës.
- Një sistem funksional për monitorimin dhe vlerësimin e përfitueshmërisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve.

## **5. Aftësitë dhe Përvoja e Kërkuar**

Kandidati/ja duhet të përmbushë këto kritere:

- Përvojë e mëparshme në hartimin dhe zhvillimin e programeve për organizata që ofrojnë shërbime sociale dhe mbështetje komunitare.
- Njohuri të thella mbi çështjet e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë te të drejtat e komunitetit LGBTI+.
- Aftësi të shkëlqyera për planifikimin strategjik, komunikimin efektiv dhe trajnimet e stafit.
- Njohuri mbi mjedisin ligjor dhe social që prek komunitetin LGBTI+ në Shqipëri dhe rajon.

## **6. Afati Kohor**

Eksperti/ja do të përfundojë zhvillimin e programit brenda një periudhe prej 2 muajsh nga data e fillimit.

## **7. Raportimi**

Eksperti/ja do të raportojë drejtpërdrejt te drejtuesit e Aleanca LGBTI+ për progresin e punës dhe për propozimet për përmirësimet e mëtejshme.

## **8. Procedura e Aplikimit**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Një letër motivimi që përshkruan përvojën e tyre dhe arsyet përse janë të përshtatshëm për këtë angazhim.
- Një CV të përditësuar me përvojat relevante.
- Një propozim teknik (deri në 2 faqe) që përshkruan qasjen dhe metodologjinë e tyre për këtë detyrë.

Aplikimet duhet të dorëzohen në adresën [aleanca.al@gmail.com](mailto:aleanca.al@gmail.com) deri më 07/10/2024.